



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 09.12.2025

**MBLEDHJA Nr. 49,
Datë 12.12.2025, ora 09:00
e Bordit të ERE-s.**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Premte, datë 12.12.2025, ora 09:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 49 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së Bordit të ERE-s më datë 17.11.2025.
2. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin nëntor 2025 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
3. Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr.73, datë 13.04.2022, “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit, për periudhën 1 maj – 31 dhjetor 2022”, për vitin 2026.
4. Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr.206, datë 16.12.2019, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “ALBGAS” sh.a. për vitin 2026”.
5. Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 154, datë 31.07.2024, “Mbi licencimin e shoqërisë “AGE ERZEN” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Hekali”.
6. Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 227, datë 28.10.2024, “Mbi licencimin e shoqërisë “ALBANIAN POWER CORE” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”.
7. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 168, datë 26.08.2024, “Mbi licencimin e shoqërisë “SUN’S MIRACLE” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”.
8. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 174, datë 29.08.2024, “Mbi licencimin e shoqërisë “FAETHON” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”.
9. Mbi shtyrjen e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit dhjetëvjeçarë të investimeve nga shoqëria Albga sh.a.”.

10. Mbi refuzimin e licencimit të shoqërisë “GET SOLAR SOLUTION” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
11. Mbi kërkesën e shoqërisë “SunPro” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
12. Mbi kërkesën e shoqërisë “GREEN ENERGY” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e aseteve fikse të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.
13. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI